



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

Në bazë të ligjit të punës nr. 03/L 2012 të Republikës së Kosovës, Organizata Jo Qeveritare Këshilli i Mediave të Shkruara, në Prishtinë, nxjerr:

RREGULLORE PËR MARRËDHËNIE PUNE

I. Dispozitat themelore

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat e brendshme për kryerjen e punëve të caktuara si dhe detyrat e punëve për punonjës në Këshillin e Mediave të Shkruara.

Çdo punonjës është i obliguar që të veprojë në pajtim me rregullat e kësaj Rregulloreje dhe Ligjit aktual të aplikueshëm në Kosovë në lëmin e marrëdhënieve të punës.

Është i ndaluar diskriminimi në zgjedhje, pranim, përfundim, caktimin dhe kryerjen e obligimeve dhe detyrave të punonjësve të Këshillit të Mediave të Shkruara në bazë të gjinisë, racës, besimit, ngjyrës, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, orientimit seksual, gjuhës ose anëtarësisë sindikale. Gjithashtu, ndalohet diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara, nëse konsiderohet se personat janë të aftë për kryerjen e punëve në mënyrë adekuate.

Çdo mosrespektim i dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjit të aplikueshëm në Kosovë, do të konsiderohet si shkelje e rregullave të punës, dhe do të jetë arsye për iniciimin e procedurës disiplinore në punë.

II. Themelimi i marrëdhënies së punës

Neni 2

Pranimi i punonjësve në punë në Këshillit të Mediave të Shkruara, bëhet në bazë të konkursit – shpalljes publike.

Pranimi i punonjësve në punë në Këshillin e Mediave të Shkruara bëhet sipas Statutit, në përputhje me planin kadrovik dhe kërkesat e punës.

Hartimi i kësaj Rregullore të Punës është mundësuar nga projekti “Fuqizimi i vetërregullimit të mediave në Kosovë”. Projekt i financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe i zbatuar nga BIRN dhe AGK.

Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës që themelojnë marrëdhënie pune me Këshillin e Mediave të Shkruara, duhet t'i përmbahen kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj.

Neni 3

Punonjësit e Këshillit të Mediave të Shkruara lidhin marrëdhënie pune në bazë të kontratës.

Puna provuese zgjat 3 muaj, varësisht nga natyra e punës dhe aftësia e të punësuarit.

Puna provuese mund të zgjatet në 6 muaj në rastet kur kapaciteti i punëtorit nuk mund të përcaktohet për 3 muaj.

Gjatë periudhës provuese të punës, punëdhënësi dhe të punësuarit, mund ta ndërpresin marrëdhënien e punës me njoftim paraprak prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Praktikanti pranohet dhe lidhë kontratë me Këshillin e Mediave të Shkruara. Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj.

Për zgjatjen e kontratës si dhe pagesën eventuale për praktikantin do të vendos Drejtori i Këshillit të Mediave të Shkruara.

III. Kontratat

Neni 4

Kontrata e punës është në formë të shkruar, qoftë për kohë të caktuar apo të pacaktuar, varësisht prej natyrës së vendit të punës.

Kontrata është e nënshkruar dhe e datuar nga ana e Drejtorit të Këshillit të Mediave të Shkruara dhe nga ana e punonjësit.

Kontrata duhet të përbëjë edhe këto elemente: vendbanimin e punonjësit, adresa, përshkrimi i punëve, detyrave konkrete dhe shërbimeve që duhet punonjësi t'i ofrojë Këshillit të Mediave të Shkruara, orari i punës, i cili mund të jetë orar i caktuar ose orar rrëshqitës, varësisht nga natyra e punës, datën e fillimit të punës, kohëzgjatjen e kontratës së punës, dhe lartësinë e kompensimit material për punën e kryer, si dhe eventualisht ndonjë pagesë ose të ardhura tjera.

IV. Shkëputja e kontratës së punës

Neni 5

Kontrata e punës së punonjësve të Këshillit të Mediave të Shkruara shkëputet në këto raste:

- 1) Me marrëveshjen paraprake të palëve nënshkruese të kësaj kontrate, pas paralajmërimit me shkrim prej së paku 15 ditëve të punës para shkëputjes së kontratës;
- 2) Për shkak të sjelljes së rëndë të marrëdhënieve në punë;
- 3) Mos respektim të kësaj rregullore të punës;
- 4) Mospërfilljes së afateve për kryerjen e punëve, moskryerjes së detyrimeve të caktuara nga përgjegjësi dhe/ose drejtori i organizatës;
- 5) Paaftësisë fizike dhe psikike që pamundëson kryerjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë;
- 6) Keqpërdorimin e informacioneve konfidenciale, apo zbulimit të sekretit të punës;
- 7) Konsumimit të mjeteve narkotike apo alkoolit në punë;
- 8) Përfundimit të nevojës për këtë vend punë për shkak të ndërprerjes dhe/ose ndryshimit të projekteve apo veprimtarisë;
- 9) Skadimit të afatit të kontratës dhe deklarimit të mos-vazhdimin të saj nga njëra ose dy palët bashkërisht si në rastet kur palët detyrohen ta shkëpusin kontratën në përputhje me Ligjin në fuqi.
- 10) në rastet e tjera të parapara me Ligjin e Punës në Kosovë.

Neni 6

Në rast të ndërprerjes së kontratës së punës, punonjësi njoftohet me shkrim për arsyet e ndërprerjes së kontratës së punës.

Në këtë rast, punonjësit i lëshohet vendimi nga ana Drejtorit të Këshillit të Mediave të Shkruara.

V. Orari i punës

Neni 7

Orari i plotë i punës i punonjësve të Këshillit të Mediave të Shkruara zgjatë 40 orë në javë. Puna fillon në ora 9 gjerë në ora 17.

Orari i punës mund të jetë edhe orar rrëshqitës, varësisht nga natyra e punëve të parapara me sistematizim të punëve.

Neni 8

Punonjësi është i obliguar të punojë edhe pas orarit të punës, varësisht nga nevoja dhe marrëveshja e ndërsjellët.

Puna jashtë orarit të punëve mund të zgjasë vetëm aq sa është e nevojshme për kryerjen e punëve urgjente, në interes të Këshillit të Mediave të Shkruara.

Puna jashtë orarit të punës kompensohet sipas marrëveshjes me menaxherin e sektorit përkatës.

Hartimi i kësaj Rregullore të Punës është mundësuar nga projekti “Fuqizimi i vetërregullimit të mediave në Kosovë”. Projekt i financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe i zbatuar nga BIRN dhe AGK.

VI. Pushimi dhe mungesat nga puna

Neni 9

Punonjësit i takon **pushimi ditor** i drekës në kohëzgjatje prej 1 ore gjatë ditës së punës dhe llogaritet në kohën e punës.

Neni 10

Mosrespektimi i orarit të punës dhe kryerjeve me sukses të punëve, tërheq konsekuenca, të shqyrtuara sipas rasteve veç e veç dhe mund të konsiderohet shkelje e rëndë e kontratës dhe rregullores.

Punonjësi duhet ta informojë menaxherin dhe Drejtorin për arsyen e çdo mungese nga vendi i punës.

Neni 11

Punonjësi ka të drejtë në **pushim vjetor** me pagesë gjatë vitit kalendarik, sipas orarit të koordinuar dhe aprovuar nga Drejtori i Këshillit të Mediave të Shkruara.

Gjatë vitit të parë të punësimit, punonjësit i takon pushimi vjetor me pagesë.

Kërkesa për pushim vjetor nga ana e punonjësit duhet të bëhet një muaj më herët, për shkak të planifikimit të punëve.

Pushimi vjetor duhet marrë gjatë vitit kalendarik në të cilën është fituar, më së voni deri më 31 qershor të vitit që pason. Pushimi vjetor nuk mund të bartet prej një viti në tjetrin, nuk mund të shndërrohet në para të gatshme.

Neni 12

Punonjësi ka të drejtë në **pushim me pagesë për raste familjare** për këto arsye:

- martesa e të punësuarit/es – 5 ditë pune;
- vdekja e anëtarëve të ngushtë të familjes të të punësuarit – 5 ditë pune;
- lindja e anëtarit të ngushtë të familjes së të punësuarit – 3 ditë pune;
- dhënia vullnetare e gjakut nga i punësuarit – 1 ditë pune.

Neni 13

Gjatë **festave zyrtare**, punonjësit i takon pushimi me pagesë.

Neni 14

Punonjësi i cili merr **pushim mjekësor**, duhet ta informojë menaxherin ose Drejtorin po atë ditë. Gjatë pushimit mjekësor, të drejtat dhe obligimet nga puna apo në lidhje me punësimin, janë të pezulluara.

Nëse pushimi mjekësor është marrë si rezultat i sëmundjes apo aksidentit në lidhje me profesionin (duke kryer detyrën zyrtare) e punonjësit, atij i sigurohet pushimi me pagesë, gjatë periudhës së mungimit nga puna.

Në rast se i punësuar nuk mund të dëshmojë se ka bërë përpjekje për ta informuar punëdhënësin për mungesën e tij/saj, punëdhënësi mund të thirret në shkelje të kontratës.

Pushimi mjekësor deri në 7 ditë, paga e punonjësit është në lartësi prej 70% të pagës bazë.
Pushimi mjekësor prej 7-15 ditë, paga e punonjësit është në lartësi prej 50% të pagës bazë.
Pushimi mjekësor prej 15-30 ditë, paga e punonjësit është në lartësi prej 30% të pagës bazë.
Pushimi mjekësor më tepër se 1 muaj, nuk kompensohet.

Neni 15

Punonjësës femër i takon **pushimi i lehonisë** me pagesë pas lindjes ashtu siç parashihet me ligjin në fuqi. Këshilli i Mediave të Shkruara aplikon edhe ligjin për gjidhënjën.

Neni 16

Këshilli i Mediave të Shkruara me kërkesë të punonjësit, mund t'i lejojë punonjësit **pushim pa pagesë**.

Në bazë të kërkesës për arsyeshmërinë dhe kohëzgjatjen e këtij pushimi, vendos Drejtori.

VII. Pagat

Neni 17

Pagat e punonjësve, sipas bazave dhe kriterëve të Këshillit të Mediave të Shkruara, përcaktohen nga ana e Drejtorit.

Me vendim të posaçëm të Drejtorit, mund të parashihen më hollësisht mënyra e shpërblimeve të veçanta të punës, si dhe lartësia e shpërblimit që i jepet personit për rezultatet e punës dhe kontributit që e ka dhënë gjatë realizimit të ndonjë projekti me rëndësi për Këshillin e Mediave të Shkruara.

VIII. Vendi i punës

Neni 18

Diskriminimi

Këshilli i Mediave të Shkruara nuk do të tolerojë ngacmime verbale apo fizike në hapësirat ku punohet. Asnjë punonjës ose mbikëqyrës nuk ka të drejtë ta fyejë ose diskriminojnë një punëtor, veçanërisht në lidhje me racën, moshën, gjininë, përkatësinë etnike, religjionin, origjinën kombëtare, orientimin seksual dhe në çfarëdo forme tjetër.

Diskriminimi përfshin veprimet, të cilat kanë për qëllim trajtimin e individëve apo grupeve në mënyrë të padrejtë, në bazë të statusit të pajustificuar, dallimet, apo paragjykimi.

Hartimi i kësaj Rregullore të Punës është mundësuar nga projekti “Fuqizimi i vetërregullimit të mediave në Kosovë”. Projekt i financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe i zbatuar nga BIRN dhe AGK.

Këshilli i Mediave të Shkruara inkurajon të gjithë punonjësit për të marrë një qëndrim pro-aktiv në ngritjen e çështjeve dhe të propozojnë zgjidhje në lidhje me zhvillimin dhe shërbimin e Këshillit të Mediave të Shkruara.

Gjatë orarit të rregullt të punës, punëtorët do të krijojnë një mjedis të pranueshëm pune, me të cilin ata rrisin efektshmërinë e tyre dhe të organizatës.

Komunikimi në hapësirat e punës dhe në vend-punimet e Këshillit të Mediave të Shkruara duhet të kryhet në mënyrë profesionale dhe zërat e ngritura nuk janë të lejuara.

Neni 19 Ngacmimi Seksual

"Ngacmimi seksual" është përkufizuar si sjellje vizuale, verbale apo fizike, që ka për qëllim apo efekt të paarsyeshëm, ndërhyrjen në punën e një punonjësi, ose që krijon një mjedis intimidues, kërcënues, armiqësor ose ofendues në punë.

"Ngacmimi seksual", është përcaktuar si çdo kërkesë paraprakisht e padëshiruar seksuale, kërkesa për favore seksuale, ose sjellje të tjera verbale apo fizike të një natyre seksuale me të njëjtin qëllim ose efekt.

Kjo mund të përfshijë:

-emrat abuzivë, fyerjet, shakatë pa baza, apo komente diskreditimi, si dhe kërkesa të padëshiruara seksuale

Të gjithë punonjësit janë përgjegjës për t'u siguruar që vendi i punës është i lirë nga ngacmimi seksual.

Të gjithë të punësuarit janë të obliguar ta shmangin çdo veprim apo sjellje, të cilat mund të konsiderohet si ngacmim seksual.

Neni 20

Punonjësit duhet të praktikojnë shprehi të mira në vendin e tyre të punës. Vendet e tyre të punës duhet gjithnjë të jenë të pastra dhe të organizuara. Materialet që nuk përdoren, gjithnjë duhet të sistemohen sipas standardeve të sistemimit dhe depozitimit të Këshillit të Mediave të Shkruara.

Muzika me zë të lartë nuk tolerohet gjatë orarit të rregullt të punës.

Sjelljet e papërshtatshme përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me:

Hartimi i kësaj Rregullore të Punës është mundësuar nga projekti "Fuqizimi i vetërregullimit të mediave në Kosovë". Projekt i financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe i zbatuar nga BIRN dhe AGK.

- Njolllosje
- Kërcënime
- Sjellje të paedukuara
- Shaka pa kriter, dhe
- Kërkesat për favore seksuale (shih nenin 19, diskriminimin/ngacmimi seksual)

Neni 21

Me fillimin e punës në Këshillin e Mediave të Shkruara, punonjësi merr përsipër obligimet e punës të përcaktuara me këtë Rregullore dhe me Ligj.

Punonjësi duhet t'i kryejë punët me profesionalizëm, korrektësi, me kohë dhe përgjegjësi.

Përshkrimi detal i punëve-detyrave, obligimeve, përgjegjësi, parashihen në kontratën e punës.

Nëse i punësuari, me fajin e tij, nuk i përmbush detyrat e punës apo nuk e respekton vendimin të cilin e ka nxjerrë punëdhënësi, mbanë përgjegjësi për shkeljen e detyrave të punës, në pajtim me ligjin dhe Kontratën e Punës.

Neni 22

Masat disiplinore për shkeljen e detyrave të punës

Nëse një punonjës ka një problem apo kërkesë në lidhje me një situatë në hapësirat e punës apo në vend-punim, ai/ ajo duhet ta informojë eprorin e tij/saj të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë. Nëse mbikëqyrësi i menjëhershëm kërkon ndihmë në trajtimin e situatës, ai/ajo do ta diskutojë çështjen me Drejtorin, dhe ata së bashku do t'i ndërmarrin masat e duhura për ta zgjidhur çështjen.

Nëse një punonjës mendon se ai/ajo ka qenë viktimë e këtyre llojeve të sjelljeve, ai/ajo është i detyruar ta informojë menjëherë Drejtorin për incidentin. Drejtori do ta kryejë një hetim të plotë dhe do t'i ndërmarrë masat e duhura disiplinore.

Në rastet kur stafi i Këshillit të Mediave të Shkruara ka përcaktuar se një punonjës ka shkelur politikat e punës së Këshillit të Mediave të Shkruara, Drejtori do të marrë një ose më shumë prej masave të mëposhtme disiplinore:

1. vërejtje me gojë;
2. vërejtje me shkrim;
3. ulje në pozitë;
4. suspendim të përkohshëm;
5. ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Masat ndëshkuese, vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe ulje - degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën e Punës dhe këtë rregullore.

Masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës, në pajtim me Kontratën e Punës dhe këtë rregullore.

Neni 23

Shqiptimin e masave

Vendimin për shqiptimin e masave ndëshkuese për shkeljen e detyrave të punës, e nxjerrë menaxheri përkatës i të punësuarit, apo Drejtori.

Neni 24

Konflikti i interesit

Të gjithë punonjësit përfshi dhe drejtorin, sekretariatit si dhe Anëtarët e Kuvendit i nënshtrohen rregullit të konfliktit të interesit.

Konflikti i interesit është mospajtimi ndërmjet detyrës zyrtare dhe interesave private, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit të tij zyrtar.

Punonjësit dhe Drejtori të cilët kanë të themeluar marrëdhënien e punës në Këshillin e Mediave të Shkruara, nuk kanë të drejtë që të marrin pjesë në asnjë votim në rastet kur votohet raporti i punës së Këshillit të Mediave të Shkruara dhe ai financiar. Pjesëmarrja në votim do konsiderohet konflikt i interesit dhe vendimi mbi atë çështje nuk do të ketë fuqi juridike, derisa të eliminohet konflikti i interesit.

Punonjësit, Drejtori dhe Anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara paraprakisht duhet ta njoftojnë Kryesuesin e Kuvendit por edhe Kuvendin në lidhje me konfliktin e interesit.

Në rastet kur punonjësit, Drejtori apo ndonjë Anëtar i Këshillit të Mediave të Shkruara dyshon se mund të ketë konflikt të interesit, ai/ajo detyrohet që menjëherë të njoftojë Kryesuesin e Kuvendin, dhe Kryesuesi do të vendos nëse ekziston konflikti i interesit.

IX. Përgjegjësia në punë

Neni 25

Me fillimin e punës në Këshilli i Mediave të Shkruara, punonjësi merr përsipër obligimet e punës të përcaktuara me këtë Rregullore dhe me Ligj.

Punonjësi duhet t'i kryej punët me profesionalizëm, korrektësi, me kohë dhe përgjegjësi.

Hartimi i kësaj Rregullore të Punës është mundësuar nga projekti “Fuqizimi i vetërregullimit të mediave në Kosovë”. Projekt i financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe i zbatuar nga BIRN dhe AGK.

Përshkrimi detal i punëve-detyrave, obligimet, përgjegjësitë, parashihen në kontratën e punës së secilit dhe në skemën organizative të hartuar nga Drejtori.

Neni 26

Prej punonjësve të Këshillit të Mediave të Shkruara pritet t'i evitojnë të gjitha veprimet, deklaratat, aktivitetet publike, të cilat mund ta dëmtojnë imazhin e Këshillit të Mediave të Shkruara.

Neni 27

Punonjësi në Këshillin e Mediave të Shkruara nuk duhet t'i nxjerrë informacionet jopublike, cilat janë në fushëveprimin e tyre. Në rastin e ndonjë dyshimi, punonjësi do të konsultohet me Drejtorin.

Punonjësit në Këshillin e Mediave të Shkruara duhet të ushtrojnë **diskrecionin maksimal** gjatë kryerjes së punës së tyre në lidhje me aktivitetet e Këshillit të Mediave të Shkruara.

Neni 27

Punonjësit duhet që mjetet e besuara në punë, t'i përdorin me kujdes.

Nga punonjësit mund të kërkohen dëmshpërblime për çdo humbje financiare të shkaktuara nga pakujdesia, duke e marrë parasysh edhe shkeljen e rregullave dhe udhëzimeve të caktuara nga Drejtori.

Punonjësit do ta kompensojnë dëmin, në bazë të vlerësimit të bërë nga komisioni të cilin do ta caktoj Drejtori.

Neni 29

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Këshillit të Mediave të Shkruara

Prishtinë, 18.12.2018

Kryetari i Kuvendit